

Mundësi për aplikim në thirrjen e hapur nga Qenda e përbashkët e kërkimeve e Komisionit Evropian (Joint Research Center- JRC)

JRC është Institucion kërkimor i Komisioni Evropian që mbështet politikë-bërjen duke siguruar ekspertizë shkencore dhe teknike. Pjesëmarrja në projektet e JRC, mund të kontribuoj në ndërtimin e kapaciteteve kërkimore të Kosovës, dhe mundëson zhvillimin në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Kush mund të aplikoj?

Universitetet/Institucionet kërkimore/ dhe ndonjëherë edhe kompani (që i plotësojnë kushtet ligjore, aftësi për të menaxhuar projekte, etj), student kërkues (early career) doktorant ose post doktorant, etj.

Thirrjet mund të jenë të ndryshme në JRC por aktualisht është e hapur thirrja:

Thirrja 2025 1 TCB NanoBiotech – JRC Nanobiotechnology Laboratory

Afati për aplikim: 1 Tetor 2025 deri 28 Nëntor 2025.

Thirrja ka të bëjë me përdorimin e Infrastrukturës Kërkimore të JRC në ISPRA/ITALI- Qasje në Laboratorin e Nanoteknologjisë të JRC, një mundësi unike për të kryer eksperimente në një ambient të avancuar ndërkombëtar.

Thirrja ndërlidhet me tema specifike, si përshembull:

- Karakterizimin e nanomaterialeve dhe nanomedikamentve (në ushqim, produktet konsumi, e të tjera), dhe ndërveprimet e sistemeve biologjike;
- Analizën e materialeve të avancuara;
- Hulumtim mbi mikro-dhe nanoplastikën;
- Të tjera

Përfitimet kryesore:

Qasje në pajisje moderne dhe Laborator të JRC;
Mbështetje teknike nga ekspertë të JRC;
Mundësi për trajnim dhe ndërtim të kapaciteteve;
Mbështetje financiare për udhëtim dhe qëndrim për pjesëmarrësit (përfitues).

Disa nga grupet e mundshme të identifikuar për thirrjen aktuale (fakultetet/Departamentet që mund të aplikojnë në bazë temës , mund të jenë nga:

Fakulteti i Shkencave matematikore-natyrore (Kimi, Biologji, Fizikë, shkenca kompjuterike, etj)
Fakulteti i Bujqësisë dhe i Veterinarisë (program/specifike në bazë të temës në thirrje)

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (program/specifike në bazë të temës në thirrje)

Fakulteti i Mjekësisë-(program/specifike në bazë të temës në thirrje), Programi Farmaci, etj.

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (program/specifike në bazë të temës në thirrje)

Programe të Teknologjisë dhe Informacionit, Shkenca të jetës, Bioteknologji, etj.

Shënim: Aplikuesit mund të hulumtojnë në JRC thirrjen dhe vlerësojnë nevojën e tyre dhe ndërlidhjen me fushën specifike nëse janë kandidat potencial për aplikim.

Detajet e gjithë procedurës së aplikimit, kriteret, vlerësimet dhe afatet i gjeni në linkun e JRC:

https://joint-research-centre.ec.europa.eu/calls-proposals/2025-1-tcb-nanobiotech-nanobiotechnology-laboratory_en#details